



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Rregulla ZRRE/Nr. 11/2017**

**RREGULLA E PROCEDURËS SË AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN  
E KAPACITETEVE TË REJA BAZUAR NË BURIMET E  
RIPËRTRITSHME TË ENERGJISË**

**Prishtinë, 27 prill 2017**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 1.15, Nenin 26 dhe Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, në seancën e mbajtur me 27.04.2017, miratoi:

## **RREGULLËN E PROCEDURËS SË AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA BAZUAR NË BURIMET E RIPËRTRITSHME TË ENERGJISË**

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulle është krijimi i procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për kapacitetet gjeneruese të mëdha bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë dhe themelimin e procedurave të thjeshtësuara për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për kapaciteteve e vogla gjeneruese bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë.

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

1. Rregulla përcakton kriteret dhe procedurat për dhënien e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë.
2. Rregulla përcakton kriteret dhe procedurat e thjeshtuara për dhënien e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja të vogla gjeneruese.
3. Procedura e autorizimit do të zbatohet në përputhje me kriteret objektive, transparente dhe jo-diskriminuese, e cila përkrah krijimin e një tregu konkurrues të energjisë duke stimuluar investimet dhe duke garantuar sigurinë dhe stabilitetin e sektorit të energjisë në Kosovë.
4. Me këtë rregull nuk do të ndalohej që ndonjë autoritet ekzistues apo institucion tjetër të lëshojë leje, pëlqime apo ndonjë dokument tjetër të nevojshëm për marrjen e Autorizimit të projektit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë.
5. Kjo rregull nuk përfshinë procedurën e autorizimit për ndërtimin e gjeneratorëve me fosile, sistemeve të reja për bartjen dhe shpërndarjen e gazit, përfshirë interkonektorët si dhe linjat direkte elektrike dhe gazsjellësin direkt për bartjen e gazit natyror, e cila do të trajtohet me rregull të veçantë në pajtim me nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin për Energji.
6. Kjo rregull nuk përfshin procedurën e tenderimit, të përcaktuar me Nenin 44 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
7. Nëse një kapacitet i ri gjenerues, është objekt i tenderimit apo do të ndërtohet si rezultat i zbatimit të procedurës tenderuese, atëherë ai nuk do të nënshtrohet kësaj Rregulle për autorizim.

### Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull, kanë kuptimin si në vijim:
  - 1.1. **Aplikues** - personi fizik apo juridik i organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare, që kryen veprimtari në energjisë i cili kërkon marrjen e autorizimit sipas kësaj rregulle;
  - 1.2. **Zyra e Rregullatorit për Energji** – (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) – agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
  - 1.3. **Vendim** – vendim i lëshuar nga Bordi i Rregullatorit, duke treguar përmbushjen me sukses të të gjitha kërkesave që rrjedhin nga kjo rregull;
  - 1.4. **Autorizim** – dhënia e autorizimit për fillimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë, brenda periudhës së specifikuar kohore sipas kësaj Rregulle;
  - 1.5. **Procedura e Autorizimit** – procedura që duhet të ndiqet për të autorizuar ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë, siç përshkruhet në këtë rregull;
  - 1.6. **Stabiliment Prodhimi** – të gjitha ndërtesat, instalimet dhe pajisjet, të bashkuara, për të gjeneruar energji elektrike, ngrohje ose kombinim të ngrohjes dhe energjisë elektrike (ko-gjenerimi), të lidhura në rrejtin përkatës;
  - 1.7. **Studim i Fizibilitetit (Zbatueshmërisë)** – vlerësim teknik, ekonomik dhe mjedisor i një projekti për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
  - 1.8. **Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtritshme të Energjisë** – dokument ligjor i nxjerr nga Ministria kompetente përgjegjëse për sektorin e energjisë në Kosovë;
  - 1.9. **Burime të Ripërtërishme të Energjisë** – burim i ripërtërishëm, jofosil i energjisë si: energjia e erës, energjia diellit, energjia gjeotermale, energjia e ujit, energjia e valëve, biomasa, gaz mbetjeve urbane, gaz i mbetjeve të trajtimit të ujërave dhe biogazi; siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për burimet e energjisë së ripërtërishme;
  - 1.10. **MMPH** - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
  - 1.11. **Organ kompetent** - organe përgjegjëse relevante të nivelit lokal dhe qendror të Republikës së Kosovës.
  - 1.12. **Kapacitete gjeneruese të mëdha** – kapacitete të reja gjeneruese me kapacitet mbi 100 kW (> 100 kW), të kyçur në rrjet;

- 1.13. **Kapacitete gjeneruese të vogla** – kapacitete të reja gjeneruese me një kapacitet deri në apo baraz me ( $\leq 100$  kW), të kyçur në rrjet;
  - 1.14. **Projekti final i Zbatimit** - hartimi i dokumentacionit tekniko-investig sipas Kodit të Ndërtimit;
  - 1.15. **Certifikata e përdorimit** - dokument i lëshuar nga një organ kompetent që vërteton përputhjen e ndërtimit me dokumentacionin ndërtimor dhe kodet e aplikuara ndërtimore, dhe që tregon se ndërtimi është i përshtatshëm për përdorim;
  - 1.16. **Gjeneratorët për Vetë-konsum**- janë konsumatorët prodhues që do të mund të ofrojnë energjinë e prodhuar në rrjetin e energjisë elektrike për konsum në të ardhmen ose t'i paguajnë furnizuesit energjinë e konsumuar në rast të bilancit negativ;
2. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike.

## **KREU II**

### **AUTORIZIMI PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË REJA**

#### Neni 4

#### **Obligimi për autorizim**

1. Asnjë person fizik ose juridik nuk mund të ndërtojë kapacitete të reja gjeneruese të bazuara në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, pa marrë paraprakisht një Autorizim me shkrim nga Rregullatori, në përputhje me procedurën e autorizimit të përcaktuar me këtë Rregull.
2. Rregullatori do t'i shqyrtojë të gjitha aplikacionet për Autorizim për ndërtimin e kapacitete të reja gjeneruese bazuar në Burimet e Ripërtrishme të Energjisë të dorëzuara në përputhje me këtë Rregull, dhe do të sigurojë që aplikacionet e tilla do të shqyrtohen në mënyrë objektive, transparente dhe jodiskriminuese.
3. Procedura e Autorizimit dhe kriteret e zbatuara nga Rregullatori janë publike.

#### Neni 5

#### **Aplikacioni për autorizim**

1. Kërkesa për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të mëdha duhet të dorëzohet me shkrim dhe në formën e specifikuar si në shtojcës 1 të kësaj Rregulle.
2. Kërkesa për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të vogla, duhet të dorëzohet me shkrim dhe në formën e specifikuar si në shtojcës 2 të kësaj Rregulle.
3. Kur Rregullatori pranon një aplikacion për marrje të Autorizimit, do të shqyrtojë atë, dhe në përputhje me këtë Rregull lëshon:
  - 3.1. Vendim për lëshimin e Autorizimit Preliminar;
  - 3.2. Vendim për lëshimin e Autorizimit Final; dhe

### 3.3. Vendimin mbi refuzimin e Autorizimit Preliminar ose Autorizimit Final.

4. Përjashtimisht nga paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i këtij neni, nëse aplikojnë më shumë se një aplikues për të njëjtin vend/lokacion ku do të ndërtohet stabilimenti i ri gjenerues, Rregullatori do ta procedojë më tutje me atë aplikacion i cili ka siguruar dëshmi relevante lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të tokës, ndërsa në rast të Hidrocentralit, aplikacioni i cili përmban Pëlqimin Ujor të lëshuar nga organi kompetent.
5. Nëse Rregullatori e konsideron të nevojshme mund të kërkojë që aplikanti të sjellë dokumente shtesë në përputhje me këtë Rregull. Kërkesa për dhënien e informacionit shtesë duhet të jetë jodiskriminuese, transparente, në kohën e duhur, i arsyeshëm dhe nuk do të kufizoj të drejtat e secilit aplikues.

## Neni 6

### Kriteret për marrjen e autorizimit

1. Aplikuesi që aplikon për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja, sipas kësaj Rregulle, gjatë të gjitha fazave të aplikimit duhet të respektojë të gjitha Ligjet, aktet nënligjore dhe rregulloret në fuqi.
2. Projektet për ndërtimin e kapacitete të reja gjeneruese duhet të siguroj performacën optimale dhe në përputhje me kriteret e mposhtëme ( informata ose dëshmi që do të paraqiten me rastin e aplikimit):
  - 2.1. arritjen e zbatimit të standardeve për mbrojtjen dhe nivelin e sigurisë që ka të bëjë me personelin, pajisjet, instalimet, makineritë, shëndetin publik dhe mbrojtjen e mjedisit;
  - 2.2. potencialin e projektit për ngritjen e konkurrencës në përputhje me zhvillimin e një tregu të liberalizuar të energjisë;
  - 2.3. përputhjen me Strategjinë e Sektorit të Energjisë të Republikës së Kosovës dhe legjislacionin e aplikueshëm për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, duke përfshirë kontributin në arritjen e objektivave të përgjithshme për pjesën e energjisë nga burimet e ripërtëritshme konsumit final bruto të aplikuar nëpërmjet Planit Kombëtar të Veprimet të Kosovës për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë;
  - 2.4. disponueshmërinë e kapaciteteve teknike dhe financiare, burime njerëzore, njohuri dhe strukturë organizative për ndërtimin dhe operimin e stabilimentit energjetik;
  - 2.5. natyrën, llojin dhe sasinë e burimeve primare të përdorura në prodhimin e energjisë elektrike, përdorimin e pajisjeve të fundit moderne (me eficienc /rendiment sa më të lartë) për stabilimentin përkatës;
  - 2.6. aplikimi i standardeve teknike sipas EU-se;
  - 2.7. aplikimin e kriterëve për efikasitetin e përgjithshëm të energjisë dhe efektet e pritura;
  - 2.6. aplikimin e standardeve në lidhje me dekomisionimin në pajtim me legjislacionin në fuqi; dhe

- 2.7. të drejtën pronësore dhe të drejta të tjera ligjore për ndërtim në lokacionin përkatës, ashtu siç është propozuar në projekt.

## KREU III

### PROCEDURA PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT

#### Neni 7

#### Procedura e aplikimit

1. Aplikacioni për autorizim për kapacitetet e reja gjeneruese të mëdha dhe për kapacitetet gjeneruese të vogla, do të plotësohet dhe dorëzohet në Rregullator në formatin e përcaktuar me Shtojcën 1 apo shtojcën 2 të kësaj rregulle.
2. Aplikacioni për autorizim duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme, duke ofruar të dhëna dhe informata të nevojshme për verifikimin e kushteve siç kërkohet me nenin 6 të kësaj Rregulle.
3. Aplikacioni për autorizim duhet të shoqërohet me dokumentet vijuese:
  - 3.1. certifikatë të regjistrimit të aplikantit si Organizatë Afariste, që i është lëshuar nga agjencia e autorizuar për regjistrimin e organizatave afariste;
  - 3.2. Statutin e themelimit të shoqërisë;
  - 3.3. Raportet e Audituarra për tre (3) vitet e fundit, e vërtetuar nga institucioni kompetent ose nga auditorët financiarë të certifikuar;
  - 3.4. Studimin e Fizibilitetit (zbatueshmërisë) i kryer për kapacitetet e reja gjeneruese;
  - 3.5. Planin e Biznesit \duke përfshirë edhe: Koston totale të investimeve dhe mënyrën e financimit; Vlerësimin ekonomik – financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare të projektit;
  - 3.6. Projektin final të zbatimit;
  - 3.7. dëshmi nga gjykata kompetente që aplikanti nuk është në procedurë likuidimi/falimentimi, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjykata dhe që aktivitetet e tij komerciale nuk janë të pezulluara;
  - 3.8. dëshmi nga organi kompetent që aplikanti i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave në vendin ku është regjistruar si person juridik;
  - 3.9. Dëshmi nga autoritetet relevante që konfirmojnë se aplikuesi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e aplikueshme statusore sipas legjislacionit relevant në Kosovë (varësisht prej projektit), përfshirë edhe të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, aty ku kërkohet.
  - 3.10. marrëveshje për kyçje në rrjet, për kapacitetin e ri gjenerues;

- 3.11. dëshmi mbi aftësitë teknike, financiare si dhe përvojën e aplikantit për të ndërtuar, poseduar ose drejtuar projekte gjeneruese,
- 3.12. dëshmi lidhur me të drejtën për shfrytëzim të tokës dhe për gjendjen pronësore të tokës që do të përdoret për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenruese të ri (vendimin për dhënie të pëlqimit për investime nga organi kompetent lokal apo qendror, marrëveshjet/kontratrat për shfrytëzim të tokës private ose publike, fletët poseduese, kopjet e planit etj.);
- 3.12. Dëshmi që konfirmojnë se Stabilimenti i planifikuar që do të ndërtohet, do të jetë në pajtueshmëri me ligjet mjedisore në Kosovë ( Pëlqimin Mjedisor ndërsa Lejen Mjedisore pas ndërtimit të gjeneratorit të ri).
- 3.13. Dëshmi për llojin, sigurinë, kualitetin e paneleve solare/fotovoltaike si dhe certifikatën mbi riciklimin (TUV certifikata), aty ku kërkohet;
- 3.14. informacione në lidhje me strukturën organizative, përfshirë biografite e menaxhmentin dhe personelin profesional të aplikantit;
4. Nëse aplikanti vepron në emër të një shoqërie aksionare, apo shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, niveli i kualifikimit të investitorit do të vlerësohet bazuar në informata duke përfshirë atë financiar, që ka të bëjë me çdo aksionar, i dërgohet Rregullatorit nga aplikanti.
5. Pas pranimit të aplikacionit, Rregullatori do ta regjistroj atë në regjistrin e aplikacioneve. Regjistri do të publikohet në ueb faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.
6. Rregullatori do të sigurojë që aplikacioni dhe të gjitha dokumentet e bashkangjitura dhe informacionet e tjera të regjistrohen, dhe do të trajtohen në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
7. Në konsultim me aplikuesin, Rregullatori mund të vendosë se cilat të dhëna ose dokumente do të konsiderohen konfidenciale, në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.

#### Neni 8

##### **Taksat për aplikim**

1. Të gjithë aplikuesit që aplikojnë për marrjen e Autorizimit, do të paguajnë taksën administrative për shqyrtimin e aplikacionit, në shumën e specifikuar nga Rregullatori sipas Rregullës për Taksat.
3. Aplikuesi duhet të sjellë kopjen e faturës së taksës së paguar, brenda tridhjetë (30) ditëve të punës, pas dorëzimit të aplikacionit për marrjen e autorizimit.
4. Pagesa e taksës administrative nuk rimburohet në rast të refuzimit të lëshimit të autorizimit.

#### Neni 9

##### **Regjistrimi i aplikacioneve**

1. Aplikacioni, s' bashku me të gjitha dokumentet mbështetëse do të dorëzohet në një (1) origjinal (kopje e shtypur) dhe në një (1) kopje elektronike - CD.
2. Aplikacioni do të dorëzohet në një nga gjuhët zyrtare në Kosovë.
3. Në rast se rdonjë dokument i bashkangjitur aplikacionit nuk është në një gjuhë zyrtare në Kosovë, Rregullatori mund ta pranoj si të tillë ose të kërkoj nga aplikuesi që të përkthehet në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe të vërtetuar nga përkthyesi zyrtar.

#### Neni 10

##### **Publikimi i aplikacioneve**

1. Brenda tetë (8) ditësh pas kompletimit të aplikacionit sipas Nenit 7 të kësaj rregulle, aplikuesi do të publikojë në dy (2) gazeta ditore që mbulojnë tërë territorin e Kosovës:
  - 1.1. një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së aplikacionit;
  - 1.2. një njoftim se çdo palë e interesuar mund të shprehë interes apo të kundërshtojë projektin e tillë brenda shtatë (7) ditësh kalendarike në Rregullator, nga data e shpalljes së njoftimit.
2. Nëse ZRRE ka pranuar ndonjë kundërshtim për aplikacionin, do t'ia paraqesë një kopje aplikuesit dhe do ta publikojë në ueb faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.
3. Në rast të paraqitjes së ndonjë kundërshtimi, sipas paragrafit 2 të këtij neni, Rregullatori do ta ndërpresë shqyrtimin e aplikacionit dhe do ta njoftojë me shkrim aplikuesin, derisa mosmarrëveshja të zgjidhet nga autoriteti përgjegjëse.
4. Aplikuesi dhe/ose Rregullatori nuk do të zbulojnë asnjë informacion që klasifikohet si konfidencial, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
5. Dispozitat e këtij Neni nuk do të zbatohen në rast të ndërtimit të gjeneratorëve të vegjël.

#### Neni 11

##### **Dorëzimi i informacioneve plotësuese**

1. Në rast se Rregullatori vlerëson se nevojiten më shumë informacione plotësuese ose sqarime nga një aplikues, do të kërkojë nga aplikuesi të dorëzoj me shkrim, e cila përfshinë kopje të shtypura apo elektronike ose të dyja, brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të aplikacionit. Afati i fundit për dorëzimin e informacioneve të tilla fillon nga dita që Rregullatori dërgon kërkesën te aplikuesi.
2. Rregullatori mund të zgjasë afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, pas pranimit të një arsytimi me shkrim nga aplikuesi lidhur me dështimin për të përmbushur afatin. Arsyetimi i tillë me shkrim duhet të shpjegoj pamundësinë e aplikantit për të siguruar informacionet e tilla e që mund të jenë jashtë kontrollit të aplikuesit.
3. Nëse aplikuesi vonon pa arsye përgjigjen e kërkuar, Rregullatori ka të drejtën ta refuzojë aplikacionin pa njoftim paraprak dhe pa rimbursuar taksën e shqyrtimit të aplikacionit, ose të



vendosë mbi aplikacionin, bazuar në dokumentet dhe informacionet ekzistuese dhe ta njoftojë aplikuesin për vendimin e saj. Aplikacioni i tillë do largohet nga Regjistri i Aplikacioneve.

4. Pas përcaktimit se për aplikacionin nuk kërkohen sqarime, informacione dhe të dhëna shtesë, ZRRE do të njoftojë aplikuesin se aplikacioni konsiderohet i kompletuar.
5. Pavarësisht nga dispozitat tjera ligjore të kësaj rregulle, Rregullatori ka të drejtë të kërkojë informacione dhe të dhëna shtesë nga aplikuesi, në çdo kohë gjatë procesit të autorizimit.

## **KREU IV AFATET DHE VENDIMET PËR AUTORIZIM**

### **Neni 12**

#### **Afatet për shqyrtimin e aplikacionit për autorizim**

1. Rregullatori do të marrë një vendim për secilin aplikacion brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike për kapacitetet e mëdha gjeneruese dhe për kapacitetet e vogla gjeneruese pas datës së njoftimit të aplikuesit se aplikacioni konsiderohet i kompletuar "gatshëm", në përputhje me kriteret e Nenit 11 paragrafit 4 të kësaj Rregulle.
2. Rregullatori mund të zgjasë afatin për shqyrtimin e aplikacionit për një periudhë shtesë deri në tridhjetë (30) ditësh kalendarike.

### **Neni 13**

#### **Vendimet e Rregullatorit mbi aplikacionet për autorizim**

1. Nëse Rregullatori përcakton se aplikuesi i ka përmbushë kërkesat dhe kriteret e përcaktuara me këtë Rregull dhe me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, atëherë:
  - 1.1. Do ta lëshojë Vendimin për Autorizimin Preliminar që konfirmon se aplikuesit do t'i jepet një Autorizim Final në bazë të kushteve të caktuara që duhet të përmbushen brenda periudhës së specifikuar kohore, siç përcaktohet me nenin 15 paragrafi 2 i kësaj Rregulle ose
  - 1.2. Do të lëshojë Autorizim Final për ndërtim e kapaciteteve të reja gjeneruese e cila ishte subjekti i aplikacionit, nëse Rregullatori është i bindur se janë plotësuar të gjitha kushtet e tjera të nevojshme dhe vlerëson se mund të lëshohet Autorizimi final.
2. Vendimi i Rregullatorit, për lëshimin e Vendimit për Autorizimin Preliminar ose Autorizimin Final do t'i dorëzohet aplikuesit, në përputhje me këtë Rregull dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

### **Neni 14**

#### **Lëshimi i Vendimit për Autorizimin Preliminar**

1. Rregullatori do t'i lëshojë aplikuesit vendimin për Autorizimin Preliminar nëse, është vërtetuar se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese,

porse nuk ka plotësuar ende kërkesat sipas paragrafit 4 të këtij neni që dalin nga legjislacioni në fuqi lidhur me ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

2. Vendimi për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të filloj ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat përkatëse dhe t'i jetë lëshuar Autorizimi Final në përputhje me këtë Rregull.
3. Vendimi për Autorizimin Preliminar do ti garanton aplikuesit se energjia e prodhuar nga Burimet e Ripërtrithme të Energjisë do të përfshihet në Skemën Mbështetëse sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në Rregullën për Skemën Mbështetëse.
4. Vendimi për Autorizimin Preliminar mund të lëshohet edhe nëse nuk janë plotësuar kërkesat si në vijim: Marrëveshja për kyçje në rrjet, Leja për Ndërtim dhe Pëlqimi Ujor apo Leja Ujore në rast të Hidrocentraleve. Këto dëshmi duhet të sillen me rastin e parashtrimit të kërkesës për shndërrimin e Vendimit për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final, sipas neni 15 të kësaj Rregulle.
5. Vendimi për Autorizimin Preliminar do të përcaktojë se aplikuesit do t'i lëshohet Autorizimi Final brenda dymbëdhjetë (12) muajsh për gjeneratorët e mëdhenj apo brenda gjashtë (6) muajsh për gjeneratorët e vegjël, varësisht se kur aplikuesi do t'i plotësojë kërkesat si në vijim:
  - 5.1. të bëjë një kërkesë me shkrim duke kërkuar që t'i lëshohet Autorizimi Final;
  - 5.2. të dorëzojë në Rregullator të gjitha dëshmitë relevante që kërkohen me legjislacionin në fuqi; dhe
  - 5.3. të përmoushë çfarëdo kushti tjetër të përcaktuar në Vendimit për Autorizimin Preliminar.
6. Afati i përcaktuar me paragrafin 5 të këtij neni mund të zgjatet edhe për një afat gjashtë (6) mujor për gjeneratorët e mëdhenj apo tre (3) muaj për gjeneratorët e vegjël nëse aplikuesi në kërkesën e tij me shkrim e arsyeton bindshëm shtyrje të afatit.
7. Pas skadimit të afatit të përcaktuar me paragrafin 5 apo 6 të këtij neni, Vendimit për Autorizimin Preliminar do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do shqyrtohet nga Bordi i Rregullatorit.
8. I njëjti aplikant, me të njëjtin projekt, mund të aplikojë (riaplikoj) vetëm edhe një herë për marrjen e Vendimit për Autorizimin Preliminar duke i rifreskuar të gjitha lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Aplikacioni i tillë do të trajtohet në përputhje me këtë Nen, me përjashtim të paragrafit 6 të këtij Neni.
9. Në rast se aplikuesi riaplikon në pajtim me paragrafin 8 të këtij neni, duhet të bëjë kërkesë me shkrim, duke arsyetuar kërkesën e tillë, dhe duke dëshmuar se për shkak të vonesave nga institucionet lokale apo qendrore në lëshimin e Lejes së ndërtimit për projektet relevante, nuk ka mundur të bëjë kërkesë për shndërrimin e Autorizimin Preliminar në Autorizim Final brenda afatit të përcaktuar ligjor.

10. Aplikuesi sipas paragrafit 8 te këtij neni me rastin e riaplikimit për përfshirjen në Rexhistrin e tarifave nxitëse do të trajtohet si aplikacion i ri sipas renditjes kronologjike.

#### Neni 15

#### **Kërkesa për shndërrimin e Autorizimin Preliminar në Autorizim Final**

1. Kërkesa për shndërrimin e Autorizimi Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të bazuar në Burimet e Ripërtrithshme të Energjisë duhet të shoqërohet me dëshmitë si në vijim:
  - 1.1. dëshmi të specifikuar për gjeneratorët e mëdhenj sipas Nenit 7 të kësaj Rregulle dhe për gjeneratorët e vegjël në përputhje me nenin 7 të kësaj Rregulle, që janë dorëzuar ose do të duhej të ishin dorëzuar së bashku me aplikacionin kur është lëshuar Vendimi për Autorizimin Preliminar, dhe
  - 1.2. dëshmi nga autoritetet relevante se aplikuesi i ka përmbushur të gjitha kërkesat e tjera ligjore në lidhje me natyrën e projektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Dëshmitë që duhet të dorëzohen për shndërrimin e Vendimit për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për gjeneratorët e mëdhenj janë si në vijim:
  - 2.1. Marrëveshja për kyçe në varësisht prej nivelit të tensionit;
  - 2.2. Pëlqimi Ujor apo Lejen Ujore në rast të Hidrocentraleve sipas Ligjit për Ujërat;
  - 2.3. Leja e ndërtimit e lëshuar sipas Ligjit për Ndërtimin në Republikën e Kosovës.
3. Dëshmitë që duhet të sillën për shndërrimin e Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për gjeneratorët e vegjël janë si në vijim:
  - 3.1. Leja Mjedisore komunale;
  - 3.2. Pëlqimi Ujor apo Leja Ujore në rast të Hidrocentraleve sipas Ligjit për Ujërat dhe
  - 3.2. Leja e Ndërtimit e lëshuar sipas Ligjit për Ndërtimin në Republikën e Kosovës.
4. Pas pranimit të kërkesës me dëshmitë relevante të cekura në paragrafin 2 ose 3 të këtij neni, Rregullatori:
  - 4.1. Do ta regjistrojë kërkesën në regjistrin e aplikacioneve për autorizim;
  - 4.2. Sigurohet se kërkesa dhe të gjitha dëshmitë e bashkangjitura, si dhe dokumentet e tjera, janë regjistruar dhe arkivuar në selinë e Rregullatorit;
  - 4.3. Të vendos cilat dokumente konsiderohen konfidenciale në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
5. Pas vlerësimit të dëshmimeve dhe të dhënave shtesë, Rregullatori do të njoftojë aplikuesin se aplikacioni është vlerësuar si i kompletuar.

#### Neni 16

#### **Dhënia e Autorizimit Final**

1. Rregullatori do të marrë vendim për secilin aplikacion brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike për gjeneratorët e mëdhenj dhe për gjeneratorët e vegjël, nga data në të cilën e ka njoftuar aplikuesin se aplikacioni është vlerësuar i kompletuar sipas Nenit 15, paragrafi 5 të kësaj Rregulle, përveç nëse Rregullatori e konsideron të nevojshme që mund të përcaktojë se periudha e shqyrtimit të aplikacionit mund të zgjatet edhe për një periudhë shtesë deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike.
2. Nëse Rregullatori përcakton se aplikuesi i ka plotësuar të gjitha kërkesat e nevojshme dhe kriteret sipas kësaj Rregulle, do ta lëshon Autorizimin Final.
3. Vendimi për Autorizimin Final lëshohet për lokacionin përkatës dhe nuk mund të transferohet në ndonjë lokacion tjetër.
4. Autorizimi Final do të përcaktojë se aplikuesi duhet ti ndërtojë kapacitetet e reja gjeneruese në kohëzgjatje sipas planit dinamik të projektit të prezantuar nga aplikanti dhe të aprovuar nga Bordi për gjeneratorët e mëdhenj dhe për gjeneratorët e vegjël, pas datës së lëshimit të Vendimit për Autorizim Final nga Bordi i Rregullatorit.
5. Afati i përcaktuar me paragrafin 4 të këtij neni mund të zgjatet edhe për një afat shtesë por jo me shume se dymbëdhjetë (12) muaj për gjeneratorët e mëdhenj dhe për gjeneratorët e vegjël, nëse aplikuesi në kërkesën e tij me shkrim e arsyeton zgjatjen e afatit me dëshmitë relevante se pengesat kanë qenë jashtë kontrollit të aplikuesit, pas vlerësimit të kërkesës nga ana e Bordit të Rregullatorit.
6. Në rast se poseduesi i Autorizimit Final nuk arrin ta perfundoj projektin brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të këtij neni, Autorizimi Final do të shfuqizohet dhe automatikisht do të përjashtohet nga Skema Mbështetëse sipas Rregullës për Skemën Mbështetëse.
7. Aplikuesi i cili i ka skaduar Autorizimi Final sipas paragrafit 7 të këtij neni ka të drejt të riaplikoj sipas dispozitave ligjore të kësaj Rregulle.
8. Rregullatori do të konsideroj projektin e finalizuar, nga data e sjelljes të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent, sipas Ligjit për Ndërtimin.
9. Vendimi për lëshimin e Autorizimit Final do të përcaktoj se aplikuesi duhet të ketë Leje Mjedisore (Ekologjike).
10. Çdo vendim i Rregullatorit mbi dhënien e Autorizimit Final sipas kësaj rregulle do t'i dorëzohet aplikuesit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

#### Neni 17

#### **Refuzimi për dhënien e autorizimit**

1. Nëse Rregullatori vlerëson se aplikuesi nuk i ka plotësuar kërkesat ose kushtet e përcaktuara sipas kësaj Rregulle, atëherë do ta refuzojë dhënien e Autorizimit Preliminar apo Autorizimit Final.

2. Çdo vendim i Rregullatorit për refuzim të Autorizimit Preliminar apo Autorizimit Final sipas kësaj rregulle, duhet:
  - 2.1. t'i dorëzohet me shkrim aplikuesit duke përfshirë arsyet e refuzimi, s'bashkui me këshillin ligjore që mundëson apelimin e vendimit të Rregullatorit; dhe
  - 2.2. të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.
3. Rregullatori për refuzimin e lëshimit të autorizimit preliminar apo Autorizimit Final do ta njoftoj Sekretariatit e Komunitetit të energjisë me qëllim të informimit në pajtim me nenin 43 paragrafi 5 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

#### Neni 18

##### **Aplikacioni për licencim**

Para përfundimit të ndërtimit, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj para finalizimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, poseduesi i Autorizimit Final duhet të bëjë aplikimin për Licencë për kapacitetet gjeneruese mbi 5 MW, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

## **KREU V MODIFIKIMI I AUTORIZIMIT**

#### Neni 19

##### **Modifikimi**

1. Modifikimi i Autorizimit mund të iniciohet nga Rregullatori ose me kërkesën e mbajtësit të Autorizimit, brenda afatit ligjor të përcaktuar në Vendimin për Autorizimin Final.
2. Kushtet e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese mund të modifikohet me anë të Vendimit të Rregullatorit, në mënyrën e specifikuar me këtë Rregull.
3. Modifikimi i Autorizimit nuk mund zbatohet në mënyrë retroaktive.

#### Neni 20

##### **Njoftimi për Modifikim**

1. Njoftimi për fillimin e modifikimit të Autorizimit për gjeneratorët e mëdhenj ose gjeneratorët e vegjël do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.
2. Njoftimi duhet të përfshijë:
  - 2.1. arsyet për fillimin e modifikimit;
  - 2.2. vlerësimin e efekteve të mundshme nëse ka; dhe

- 2.3. një shpjegim se çdo palë e interesuar mund të shpreh interesin apo të kundërshtojë një modifikim të tillë brenda shtatë (7) ditësh kalendarike në Rregullator nga data e shpalljes së njoftimit.

#### Neni 21

##### **Vendimet për Modifikim**

1. Për të vendosur lidhur me Modifikimin e Autorizimit, Rregullatori do të marrë parasysh:
  - 1.1. arsyetimet e dhëna nga mbajtësi i Autorizimit;
  - 1.2. vërejtjet e dorëzuara nga palët e tjera;
  - 1.3. dëshmitë (lejet) e nevojshme të lëshuara nga institucionet relevante dhe
  - 1.4. modifikimi duhet të përputhet me kriteret në bazë të cilave është bërë dhënia e autorizimit.
2. Vendimi i Rregullatorit për Modifikim sipas kësaj Rregulle do t'i dorëzohet palës dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

#### Neni 22

##### **Përfundimi i Autorizimit**

1. Autorizimi mund të përfundojë në përputhje me afatet dhe kushtet e dhënies së Autorizimit, të përcaktuara si më poshtë:
2. Rregullatori mund të përfundojë Autorizimin në rast se:
  - 2.1. mbajtësi i Autorizimit bën shkelje të kushteve të përfshira në Autorizim, shkelje të Ligjeve në fuqi, dispozitave të kësaj rregulle ose rregullave të tjera në fuqi;
  - 2.2. dhënia e Autorizimit është bazuar në informacione të rreme ose të gabuara;
  - 2.3. skadimi i periudhës së vlefshmërisë së Autorizimit ndodh para përfundimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese;
  - 2.4. me kërkesë të mbajtësit të Autorizimit;
  - 2.5. shpërbëhet personi juridik që mban Autorizimin;
  - 2.6. nëse gjykata ka marrë një vendim me të cilin e shpall financiarisht të paaftë mbajtësin e Autorizimit ose ndërpret aktivitetin e mbajtësit të Autorizimit;
  - 2.7. mbajtësi i Autorizimit kryen aktivitete në kundërshtim me autorizimin; dhe
  - 2.8. ndodh mospagesa e dënimit me gjobë e shqiptuar për mospërbushje të kushteve të Autorizimit, siç është përcaktuar në Nenin 23 të kësaj Rregulle.

#### Neni 23

##### **Dispozitat ndëshkimore**

1. Nëse ndonjë person fizik apo juridik fillon ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese pa pasur Autorizim të lëshuar të vlefshëm për atë objekt të dhënë në përputhje me këtë Rregull, ai person mund të jetë subjekt i gjobës sipas Nenit 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat e nxjerr nga Rregullatori.

2. Nëse mbajtësi i autorizimit kryen ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese në kundërshtim me kushtet e dhëna me Autorizim, mund ti shqiptohet gjoba sipas Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat e nxjerr nga Rregullatori.
3. Gjatë shqiptimit të dënimit me gjobë sipas këtij neni, Rregullatori do të njoftojë personin për shkeljet e bëra dhe do t'i japë një mundësi dhe kohë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda katërbëdhjetë (14) ditësh kalendarike nga data e njoftimit.
4. Nëse gjoba e shqiptuar nga Rregullatori nuk paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor, Rregullatori do të fillojë procedurën gjyqësore për pagesën e gjobës si borxh civil.
5. Nëse mbajtësi i Autorizimit nuk arrin t'i përmbushë kushtet e përcaktuara në Autorizim apo nuk përmbush ndonjë nga kërkesat e përcaktuara me këtë Rregull, Rregullatori mund ta shfuqizojë Autorizimin ose ta refuzojë dhënien e licencës për kapacitetet mbi 5 MW për operim e kapaciteteve të reja gjeneruese për të cilin është lëshuar Autorizimi.
6. Shfuqizimi i Autorizimit dhe refuzimi i dhënies së Licencës janë sanksione serioze dhe duhet të aplikohen vetëm pasi që bartësit të Autorizimit i është dhënë mundësia për të korrigjuar shkeljet e bëra.

#### Neni 24

#### **Apelimi i vendimit të Rregullatorit**

Vendimi i Rregullatorit lidhur me lëshimin apo refuzimin për dhënien e Autorizimit mund të kontestohet vetëm në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

### **KREU V**

#### **PROCEDURA E APLIKIMIT PËR GJENERATORËT PËR VET-KONSUM**

#### Neni 25

#### **Procedura e Aplikimit**

1. Personi fizik apo juridik i cili planifikon të ndërtoj kapacitete të reja gjeneruese për vet-konsum, është i obliguar të parashtron kërkesë me shkrim në Rregullator duke i plotësuar dëshmitë relevante.
2. Dëshmitë që duhet të plotësohen janë si në vijim:
  - 2.1 Dëshmia nga KEDS për konsumin e energjisë vjetore;
  - 2.2 Vlerësim për prodhimin vjetor në kWh të pajisjeve të instaluara;
  - 2.3 Pëlqimi për kyçje në rrjet i lëshuar nga KEDS; dhe
  - 2.4 Pëlqimi nga komuna përkatëse.
3. Rregullatori pas pranimit të dëshmimeve relevante si në paragrafin 2 të këtij neni, nëse e vlerëson se dëshmitë e sjellura janë të kompletuara, brenda afatit ligjor të përcaktuar me

nenin 16 të kësaj Rregulle do të lëshoj një vendim në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum.

## **KREU VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 26 Dispozitat Kalimtare**

1. Aplikuesit të cilët posedojnë Vendim për Autorizim Preliminar apo Autorizim Final të lëshuar para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, do të trajtohen sipas Rregullës për procedurën e autorizimit të nxjerrë me datë 11.11.2014 nga ZRRE, dhe do të mbesin në fuqi deri në skadimin e afatit ligjor të përcaktuar në vendimet përkatëse.
2. Aplikuesit të cilën kanë aplikuar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulle, e të cilët nuk kanë arritur të pajisen me Autorizim Preliminar do të vazhdojnë procesin në përputhjet me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit të nxjerrë me datë 11.11.2014 nga ZRRE.

### **Neni 27 Ndryshimi**

1. Rregullatori mban të drejtën që ta ndryshoj ose ta modifikojë çdo dispozitë të kësaj rregulle.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të kësaj Rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

### **Neni 28 Interpretimi**

Në rast të paqartësive për dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi i Rregullatorit do të nxjerrë informacione shpjeguese.


### **Neni 29 Shfuqizimi**


Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulle shfuqizohet Rregulla e Procedurës së Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja, e nxjerrë në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 dhe miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më 11.11.2014.

### **Neni 30 Hyrja në fuqi**

Rregulla hyn në fuqi në datën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

**Bordi i Zyres se Rregullatorit për Energji :**

  
Krenar Bujupi, u.d kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj anëtar



## Shtojca 1

# APLIKACION PËR AUTORIZIM- Gjenerator të mëdhenj

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI APLIKUESIN					
EMRI I APLIKUESIT (PERSONIT JURIDIK):					
SELIA:					
ADRESA:					
NR. I REGJISTRIMIT:					
NR. I TELEFONIT:			NR. I FAKSIT:		
ADRESA E E-MAIL-IT:					
EMRI DHE MBIEMRI I PERSONIT KONTAKTUES:					
ADRESA:					
NR. I TELEFONIT:			NR. I FAKSIT:		
ADRESA E E-MAIL-IT:					
INFORMACIONE SPECIFIKE PËR GJENERATORIN, SIPAS NJËSIVE					
EMRI I NJËSISË	LOKACIONI	KOMUNA	BURIMI I ENERGJISË	KAPACITETI I INSTALUAR (MW)	PRODHIMI (VJETOR)

## Udhëzime për plotësim

- 1) Aplikuesi duhet të bashkëngjisë të gjitha dokumentet/dëshmitë e mëposhtme dhe t'i dorëzojë në Rregullator, së bashku me aplikacionin, në përputhje me këtë Rregull.
- 2) Çdo dokument i bashkëngjitur duhet të shënohet qartë me një tregues që i referohet dokumentit përkatës.
- 3) Aplikacioni duhet nënshkruar nga aplikuesi.
- 4) Për secilën pikë të aplikacionit të bashkëngjitet një deklaratë e vulosur dhe e nënshkruar nga aplikuesi.

### **A: Kërkesa të përgjithshme**

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
1.	Certifikata e regjistrimit si një kompani afariste të lëshuar nga ARBK.		
2.	Dëshmi për themelimin e shoqërisë (Statuti i Shoqërisë.)		
3.	Dëshmi nga gjykata kompetente që aplikuesi nuk është në procedurë likuidimi/falimentimi, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjykata dhe që aktivitetet e tij komerciale nuk janë të pezulluara;		
4.	Dëshmi nga organi kompetent që aplikuesi i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave në vendin ku është regjistruar si person juridik;		
5.	Ne rast të partneritetit: Marrëveshjet në fushat e caktuar lidhur me Ekzekutimin e kontratës/ave.		
6.	Referenca mbi pervojen afaritese të aplikuesit apo të partnereve në fushen e BRE-ve apo te ngjajshme.		
7.	Letër mbështetje nga Banka apo të ndonjë huadhënësi.		
8.	Raportet e Audituarra për tre (3) vitet e fundit, të vërtetuar nga institucioni kompetent ose nga auditorët financiarë të certifikuar.		

### **B: Kërkesa teknike dhe organizative**

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO	
		PO	JO
9.	Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar bazuar në të dhëna dhe matje reale të kryera në zonat e zbatimit të projektit ku të përfshihen: përshkrimi i përgjithshëm i projektit, kushtet klimatike dhe meteorologjike për zonën e projektit sipas tipit të gjeneratorit; përshkrimi teknik i zgjedhjes së çdo elementi të gjeneratorit bazuar në të dhënat e mësipërme; llogaritjet në të		

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO	
		PO	JO
	cilat bazohen përzgjedhjet e kryera; studimi, llogaritjet dhe përzgjedhjet e pajisjeve për lidhjen me sistemin e rrjetit të energjisë; studimi dhe analize e kushteve gjeologjike-inxhinierike të zonës ku do të zbatohet projekti dhe Strukturën organizative të aplikuesit dhe CV-te e stafit. Studimi i fizibilitetit medoemos duhet të përfshij Planin e Biznesit (Koston totale të investimeve dhe mënyrën e financimit; Vlerësimin ekonomik – financiar të projektit) .		
10	<b>Projektin Final të Zbatimit</b>		
11	Informata teknike për kyçe e lëshuar nga KEDS apo KOSTT, varesisht prej nivelit.		
12	Dëshmi lidhur me të drejtën për shfrytëzim të tokës dhe për gjendjen pronësore të tokës që do të përdoret për ndërtimin e gjeneratorit (Vendimi për dhënie të pëlqimit nga organet komunale, fletët poseduese, kopjet e planit, marrëveshjet/kontratat për shfrytëzim të tokës private ose publike etj.).		
13	Pëlqimin Mjedisor nga MMPH.		
14	<b>Dëshmi për llojin, sigurinë, kualitetin e paneleve solare/fotovoltaike si dhe certifikatën mbi riciklimin (TUV certifikata).</b>		

### ***C: Kërkesa financiare***

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
15.	Kërkesa për Pranim në Skemën Mbështetëse, sipas Rregullës për pranim në Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtrithme të Energjisë.		

### ***D: Kërkesat për Autorizim Final***

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur për shëndrrimin e Autorizimit Preliminar në Autorizim Final:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
1.	Marrëveshja për kyçe, varësisht prej nivelit të tensionit.		
2.	Pëlqimi Ujor apo Leja Ujore në rast të Hidrocentraleve nga MMPH.		
3.	Leja e ndërtimit e lëshuar sipas Ligjit për Ndërtimin në Republikën e Kosovës.		
4.	Planin dinamik të projektit mbi ekzekutimin e punimeve		

Shtojca 2

## APLIKACION PËR AUTORIZIM –Gjenerator të vegjël

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI APLIKUESIN					
EMRI I APLIKUESIT (PERSONIT JURIDIK):					
SELIA:					
ADRESA:					
NR. I REGJISTRIMIT:					
NR. I TELEFONIT:			NR. I FAKSIT:		
ADRESA E E-MAIL-IT:					
EMRI DHE MBIEMRI I PERSONIT KONTAKTUES:					
ADRESA:					
NR. I TELEFONIT:			NR. I FAKSIT:		
ADRESA E E-MAIL-IT:					
INFORMACIONE SPECIFIKE PËR GJENERATORIN, SIPAS NJËSIVE					
EMRI I NJËSISË	LOKACIONI	KOMUNA	BURIMI I ENERJISË	KAPACITETI I INSTALUAR (MW)	PRODHIMI (VJETOR)

## Udhëzime për plotësim

- 5) Aplikuesi duhet të bashkëngjisë të gjitha dokumentet/dëshmitë e mëposhtme dhe t'i dorëzojë në Rregullator, së bashku me aplikacionin, në përputhje me këtë Rregull.
- 6) Çdo dokument i bashkëngjitur duhet të shënohet qartë me një tregues që i referohet dokumentit përkatës.
- 7) Aplikacioni duhet nënshkruar nga aplikuesi.
- 8) Për secilën pikë të aplikacionit të bashkëngjitet një deklaratë e vulosur dhe e nënshkruar nga aplikuesi.

### **A: Kërkesa të përgjithshme**

	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
1.	Certifikata e regjistrimit si një kompani afariste të lëshuar nga ARBK.		
2.	Dëshmi për themelimin e shoqërisë (Statuti i Shoqërisë).		
3.	Dëshmi nga gjykata kompetente që aplikuesi nuk është në procedurë likuidimi/falimentimi, që biznesi i tij nuk administrohet nga gjykata dhe që aktivitetet e tij komerciale nuk janë të pezulluara.		
4.	Dëshmi nga organi kompetent që aplikuesi i përmbush detyrimet ligjore lidhur me pagimin e taksave në vendin ku është regjistruar si person juridik.		

### **B: Kërkesa teknike dhe organizative**

	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO	
		PO	JO
6.	Informata teknike për kyçje e lëshuar nga KEDS, varësisht prej nivelit.		
7.	<b>Plani i Biznesit</b> duke përfshirë edhe: Koston totale të investimeve dhe mënyrën e financimit; Vlerësimin ekonomik – financiar të projektit .		
8.	Dëshmi lidhur me të drejtën për shfrytëzim të tokës dhe për gjendjen pronësore të tokës që do të përdoret për ndërtimin e gjeneratorit të ri (Vendimi për dhënie të pëlqimit nga organet komunale, fletët poseduese, kopjet e planit, marrëveshjet/kontratat për shfrytëzim të tokës private ose publike etj.).		
9.	<b>Kërkesat e tjera relevante legislative, përfshirë edhe të drejtat mbi ujin.</b> Kërkesa për aplikim për Leje Mjedisore komunale.		
10.	Projekti final i Zbatimit.		
11.	Dëshmi për llojin, sigurinë, kualitetin e paneleve solare/fotovoltaike si dhe certifikatën mbi riciklimin (TUV certifikata).		

### ***C: Kërkesa financiare***

	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
12.	Kërkesa për Pranim në Skemën Mbështetëse, sipas Rregullës për pranim në Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtitshme të Energjisë.		

### ***D: Kërkesat për Autorizim Final***

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhet bashkëngjitur për shëndrrimin e Autorizimit Preliminar në Autorizim Final:	Shëno me PO ose JO:	
		PO	JO
1.	Marrëveshja për kyçje në rrjet.		
2.	Leja Mjedisore komunale.		
3.	Pëlqimi Ujor apo Leja Ujore në rast të Hidrocentraleve nga MMPH.		
4.	Leja e Ndërtimit e lëshuar sipas Ligjit për Ndërtimin në Republikën e Kosovës.		
5.	Planin dinamik të projektit mbi ekzekutimin e punimeve		